



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.07.2023, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Petro Koçi – zëvendëskryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Diskutimi, me kërkesën e ¼-tës së deputetëve të komisionit, i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin, nr.53/2019, datë 18.7.2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë””, propozim i një grupi deputetësh (*komision përgjegjës*).

#### **Marrin pjesë:**

Petro Koçi, Lindita Buxheli, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Blerina Gjylameti, Enslemvera Zake, Ilir Topi, Ismet Beqiraj (zëvendësues), Fadil Nasufi (zëvendësues), Luljeta Bozo (zëvendësuese) dhe Lavdrim Krrashi (zëvendësues).

#### **Mungojnë:**

Flutura Açka, Ilir Metaj, Dasantila Tahiraj, Florenc Spaho, Agron Gjekmarkaj, Ina Zhupa, Merita Bakiu, Eralda Bano, Andia Ulliri, Kastriot Piroli, Orjela Nebijaj, Meri Markiçi.

## HAPET MBLEDHJA

**Petro Koçi** – Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Fillojmë mbledhjen e rregullt të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Kjo është një mbledhje e thirrur në bazë të nenit 32, pika 2, të Rregullores, sipas të cilit mbledhjet e komisionit të përhershëm thirren edhe me kërkesën e jo më pak se një të katërtës së anëtarëve të komisionit. Këtë gjë e kemi bërë dje, nëpërmjet rrugëve zyrtare, komunikimit elektronik, dhe më shumë se një e katërta e anëtarëve të këtij komisioni ka kërkuar mbledhjen e komisionit, duke përcaktuar kërkesën dhe çështjet që do të diskutohen në mbledhje.

Siç e dini, kemi bërë një odise të gjatë diskutimesh për projektligjin “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, i cili është propozuar nga unë dhe nga zoti Beqiraj; ka mbështetjen e të gjithë asamblesë së Akademisë së Shkencave dhe këtu kemi bërë dëgjesa të plota jo vetëm me të vetmin anëtar të kësaj Akademie, zotin Fuga, që është kundër këtij projektligji, por edhe me drejtues të Akademisë, më pas edhe me iniciatorin, zotin Beqiraj, si dhe janë zhvilluar shumë diskutime të tjera nga deputetët e opozitës, por edhe të mazhorancës në këtë komision.

Në mënyrë të parregullt, kryetarja e komisionit nuk ka lejuar votimin dhe procedimin sipas Rregullores, për t’i dhënë fund gjithë kësaj odiseje, megjithëse ka qenë e përcaktuar qartazi edhe në kalendar dhe ka qenë detyrë e komisionit, por edhe e kryetares, që ta përfundonte votimin, pavarësisht se ajo është kundër.

Tani, ky proces ka mbaruar. Shumica e anëtarëve të komisionit janë prezentë dhe le të fillojmë, së pari, me votimin në parim të projektligjit.

Kush është pro në parim? Janë 9 vota pro. Kundër? Abstenim? 1 abstenim.

Faleminderit!

Fillojmë me votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord, sipas formulimit në draft? Kundër? Abstenim? 1 abstenim.

Faleminderit!

Neni 2. Kush është dakord, sipas formulimit në draft? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 2 abstenime.

Neni 3, sipas reflektimit të iniciatorëve: neni 11, pika 4, riformulohet si bashkim i pikave 9 dhe 10, pra jo si në draft: “pikat 8 dhe 9”, dhe në fund pika 11 e këtij neni bëhet 8. Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 2 abstenime.

Kush është dakord me nenin 4, sipas projektligjit? Kundër? Abstenim? 2 abstenime.

Kush është dakord me nenin 5 të projektligjit? Kundër? Abstenim? 3 abstenime.

Hedhim në votim nenin 6, për të cilin edhe ne si iniciatorë jemi shprehur kundër. Ju lutem, votoni kundër këtij neni! Kush është pro? Nuk ka asnjë pro. Kundër? Të gjithë janë kundër. Abstenim?

Neni 7, duke hequr nenin 6, bëhet neni 6, që ka të bëjë me hyrjen në fuqi.

Kush është dakord me nenin 6? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 2 abstenime.

Kalojmë në votimin e projektligjit në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 3 abstenime.

Faleminderit!

## **MBYLLET MBLEDHJA**